

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 297, Datë 17.11.2025

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 123, DATË  
04.04.2023 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SUN ENERGY SOLUTIONS”  
SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar;; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 2872 prot., datë 14.11.2025, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 123, datë 04.04.2023 “Mbi licencimin e shoqërisë “SUN ENERGY SOLUTIONS” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2MW”,

**Konstatohet se:**

**1. Të dhëna mbi shoqërinë “SUN ENERGY SOLUTIONS” sh.p.k.**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 123, datë 04.04.2023, ka licencuar shoqërinë “SUN ENERGY SOLUTIONS” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në fshatin Sheq Marinas, njësia administrative Topojë, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar.
- Në pikën 2 të vendimit 123/2023 përcaktohet se “Shoqëria duhet të informojë ERE-n çdo 2 (dy) muaj në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik, deri në datën 06.09.2024”.
- Gjithashtu në pikën 3 të këtij vendimi përcaktohet se “Ky vendim është objekt rishikimi”.

**2. Korrespondenca dhe Dokumentacioni i Depozituar nga Shoqëria**

- Shoqëria “SUN ENERGY SOLUTIONS” sh.p.k. ka depozituar pranë ERE-s raportimet periodike për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik për periudhën janar – shtator 2025. Nga shqyrtimi i këtyre raportimeve rezulton se shoqëria ka hyrë në prodhim dhe po ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me kushtet e përcaktuara në vendimin e licencimit.

**3. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi**

- Shoqëria ka hyrë në prodhim përpara afatit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE nr. 123, datë 04.04.2023, duke përmbushur plotësisht kushtin e vendosur në vendim. Për rrjedhojë, ky kusht konsiderohet i realizuar dhe duhet të shfuqizohet.
- Me shfuqizimin e këtij kushti, duhet të shfuqizohet dhe pika 3 e vendimit 123/2023 e cila përcakton se ky vendim është objekt rishikimi në kuadër të plotësimit të kushtit të përcaktuar në pikën 2.

#### **4. Nevoja për Ndryshimin e Vendimit**

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet se pikat 2 dhe 3 të dispozitivit të vendimit të bordit të ERE-s nr. 123, datë 04.04.2023, duhet të shfuqizohen, pasi shoqëria “SUN ENERGY SOLUTIONS” sh.p.k. ka përmbushur kushtin përkatës dhe duhet të reflektohet situata aktuale e realizimit të projektit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Pikat 2 dhe 3 të vendimit të ERE-s nr. 123, datë 04.04.2023, shfuqizohen.
2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë shoqërinë “SUN ENERGY SOLUTIONS” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OSSH” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**